



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E EKONOMISE**

*Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla dhe te Mesme*

**URDHER**

Nr. 4 Date 9 7 .2004

**PER**

**TRANSFORMIMIN E NDERMARRJES SHTETERORE "UJESJELLES FSHAT" SHKODER  
NE SHOQERI ANONIME "UJESJELLES FSHAT" SH.A. SHKODER**

**Drejtuar: Ndermarrjes "Ujesjelles Fshat" Shkoder**

Duke marre parasysh percaktimin e kapitalit themeltar te shoqerise qe do te krijohet nga transformimi i Ndermarrjes "Ujesjelles Fshat" Shkoder ne baze te Urdherit nr. 131, date 04.10.2002 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri anonime" dhe shkreses nr. 8572, date 24.11.2003 "Per zbatim te Urdherit nr. 131, date 04.10.2002 te Ministrit te Ekonomise",

**KONSTATOVA**


Se ne baze te nenit 1 te Ligjit nr. 8885, date 22.04.2002 "Per disa ndryshime ne ligjin nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Ligjin nr. 8067, date 15.02.1992; nr. 8099, date 28.03.1996; nr. 8158, date 1.09.1997; nr. 8482, date 10.05.1999, dhe me Dekretet nr. 1195, date 14.08.1995 dhe nr. 1615, date 20.09.1996 duhet te krijohen aktet e themelimit te Shoqerise,

Persa me siper, ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, me cilesine e aksionerit te vetem te shoqerise,

**URDHEROJ:**

1. Transformimin e Ndermarrjes "Ujesjelles Fshat" Shkoder ne Shoqeri te formes anonime "Ujesjelles Fshat" Sh.a. Shkoder
2. Anetare te keshillit te pare mbikqyres emerohen:  
Z. Arben Rexhepi  
Znj. Lindita Radovani  
Znj. Manjola Lesha
3. Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla e te Mesme dhe Drejtoria Juridike te ndjeke zbatimin e ketij urdheri.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

  
Ilir CIKO  
ZV/MINISTËR